



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË
DREJTORIA JURIDIKE

Nr. 5875 / prot.

Himarë, më 10 . 10 . 2024

PROJEKT-VENDIM

Nr. 32 , Datë 10/10/2024

PËR

**“MIRATIMIN E RREGULLORES SË MENAXHIMIT TË MBETJEVE VOLUMINOZE
NË BASHKINË E HIMARËS”**

Bazuar në Ligjin Nr.139/2015, datë 19.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, *i ndryshuar*, ligjin Nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, ligjin Nr. 8094, datë 21.03.1996 “Për largimin publik të mbeturinave”, ligjin Nr. 10463, datë 22.9.2011 “Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve”, *i ndryshuar*, ligjin Nr. 10 431, datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”, të ndryshuar, ligjin Nr. 10448 datë 14.07.2011 “Për lejet e mjedisit”, të ndryshuar, ligjin Nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për Kundravajtjet Administrative”, ligjin Nr.89/2022 “Për policinë Bashkiake”, VKM Nr.452, datë 26.07.2023 “Për miratimin e rregullores kuadër të policisë Bashkiake”, VKM Nr.575, datë 24.6.2015 “Për miratimin e kërkesave menaxhimin e mbetjeve inerte”, VKM Nr.660, datë 31.10.2018 “Për miratimin e kërkesave për menaxhimin mbetjeve të metaleve”, VKM Nr.608, datë 17.9.2014 “Për Përcaktimin e masave të nevojshme për grumbullimin dhe trajtimin e mbetjeve bio si dhe kriteret dhe afatet për pakësimin e tyre”, VKM Nr.687 datë 29.07.2015 “Për miratimin për mbajtjen, përditësimin dhe publikimin e statistikave të mbetjeve”, *i ndryshuar*, VKM Nr.418 datë 25.06.2014 “Për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në burim”, VKM Nr.957, datë 19.12.2012 “Për mbetjet nga pajisjet elektrike dhe elektronike”, VKM Nr.866, datë 04.12.2012 “Për bateritë, akumulatorët dhe mbetjet e tyre”, VKM Nr.652 datë 14.09.2016 “Për rregullat dhe kriteret për menaxhimin e mbetjeve për gomat e përdorura”, Ligjit nr. 9010, datë 13.02.2003 “Për administrimin mjedisor të mbetjeve të ngurta” si dhe VKB Himarë Nr.8 datë 20.08.2019 “Mbi miratimin e planit bashkiak të menaxhimit të mbetjeve të ngurta për Bashkinë Himarë si dhe miratimin e vënies në dispozicion të hapësirës të stabilizimit dhe kompostimit pranë stacionit të transferimit të mbetjeve në Vumlo”. Me propozimin e kryetarit të Bashkisë Himarë:

Këshilli i Bashkisë Himarë në mbledhjen e datës ___ / ___ /2024

VENDOSI:

1. Miratimin e "Rregullores së menaxhimit të mbetjeve voluminoze në Bashkinë e Himarës".
2. Per zbatimin e këtij Vendimi ngarkohet Kryetari dhe Administrata e Bashkisë Himarë.

Ky Vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes, bazuar ne Ligjin nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore".

KRYETARI

Vangjel Tavo





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË
DREJTORIA JURIDIKE

Nr. 5875/prot.
/2

Himarë, më 10.10.2024

RREGULLORE PËR MENAXHIMIN E MBETJEVE VOLUMINOZE

Përmbajtja:

- Neni 1.....Qëllimi
- Neni 2.....Objekti
- Neni 3.....Baza ligjore
- Neni 4.....Tipologjia e materialeve të cilët do të mblidhen në banesë
- Neni 5.....Mbetjet voluminoze objekt i rregullores
- Neni 6.....Veçimi, sistemimi dhe Dorëzimi i Mbetjeve voluminoze
- Neni 7.....Shërbimi i mbledhjes në banesë
- Neni 8.....Mënyra e dhënies së shërbimit
- Neni 9.....Transport i mbetjeve voluminoze
- Neni 10.....Dispozita për subjektet private
- Neni 11.....Dorëzimi i mbetjeve vegjetale dhe inerte
- Neni 12.....Ndalimet
- Neni 13.....Sanksionet për shkeljen e rregullores
- Neni 14.....Sanksionet në rast përsëritje
- Neni 15.....Norma integruese

Neni 1
Qëllimi

1. Kjo rregullore synon të krijojë një mjedis të favorshëm për zbatimin e legjislacionit për menaxhimin e mbetjeve voluminoze duke përcaktuar detyrimet dhe përgjegjësitë e të gjithë aktorëve që janë të përfshirë në procesin e menaxhimit të mbetjeve të voluminoze.
2. Analizën e të gjithë elementeve teknikë të sistemit (grumbullimi, transporti, reduktimi, riciklimi, kompostimi dhe trajtimi).
3. Sigurimin e një monitorimi periodik në procesin e zbatimit të tyre, një menaxhim sa më eficient të mbetjeve voluminoze dhe përmirësimin e cilësisë të shërbimit të pastrimit në territorin e bashkisë Himarë.

Neni 2 **Objekti**

1. Rregullorja në fjalë ka objekt disiplinimin e manaxhimit të mbetjeve urbane voluminoze të gjeneruara në territorin e Bashkisë Himarë, i cili do të kryhet në mënyrë të tillë që të sigurojë një mbrojtje të lartë të mjedisit. Objekti i rregullores do të jenë:
 - a. Shmangia e braktisjes së mbetjeve voluminoze në territorin e bashkisë;
 - b. Krijimi i lehtësive për qytetarët lidhur me transportin dhe trajtimin e mbetjeve voluminoze;
 - c. Sigurimi i një manaxhimi korrekt të këtyre mbetjeve, duke garantuar një trajtim të vazhdueshëm duke favorizuar rikuperimin e materialeve voluminoze.
 - ç. Rritjen e sasisë së mbetjeve të selektuara.
2. Standardet lokale të punës dhe cilësisë, metodologjitë dhe teknologjitë, rregullat e sigurisë dhe të shëndetit për shërbimet e pastrimit dhe të administrimit të mbetjeve.
3. Rregullat dhe detyrimet e prodhuesve të mbetjeve, si dhe sanksionet në raste të shkeljeve të përcaktuara në këtë rregullore.
4. Marrjen e masave parandaluese për mosdjegien e mbetjeve, për mos'hedhjen e mbetjeve në rrymat ujore (lumë, përrua, kanal), det apo në vende të tjera nga ato të miratuara nga bashkia.

Neni 3 **Baza ligjore**

- Ligji Nr. 8417, datë 21.10.1998 "Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar;
Ligji Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar;
Ligji Nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore"
Ligji Nr. 8094, datë 21.03.1996 "Për largimin publik të mbeturinave";
Ligji Nr. 10463, datë 22.9.2011 "Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve", i ndryshuar ;
Ligji Nr. 10 431, datë 9.6.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit", të ndryshuar ;
Ligji Nr. 10448 datë 14.07.2011 "Për lejet e mjedisit", të ndryshuar;
Ligji Nr. 10279, datë 20.05.2010 "Për Kundravajtjet Administrative";
Ligji Nr.89/2022 "Për policinë Bashkiake"
V KM Nr.452, datë 26.07.2023 "Për miratimin e rregullores kuadër të policisë Bashkiake";
V KM Nr.575, datë 24.6.2015 "Për miratimin e kërkesave menaxhimin e mbetjeve inerte";
VKM Nr.660, datë 31.10.2018 "Për miratimin e kërkesave për menaxhimin mbetjeve të metaleve",
VKM Nr.608, datë 17.9.2014 "Për Përcaktimin e masave të nevojshme për grumbullimin dhe trajtimin e mbetjeve bio si dhe kriteret dhe afatet për pakësimin e tyre";
V KM Nr.687 datë 29.07.2015 "Për miratimin për mbajtjen, përditësimin dhe publikimin e statistikave të mbetjeve", i ndryshuar ;
VKM Nr.418 datë 25.06.2014 "Për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në burim";

V KM Nr.957, datë 19.12.2012 "Për mbetjet nga pajisjet elektrike dhe elektronike";
V KM Nr.866, datë 04.12.2012 "Për bateritë, akumulatorët dhe mbetjet e tyre
VKM Nr.652 datë 14.09.2016 "Për rregullat dhe kriteret për menaxhimin e mbetjeve për gomat e përdorura".
Ligjit nr. 9010, datë 13.02.2003 "Për administrimin mjedisor të mbetjeve të ngurta"

Neni 4

Tipologjia e materialeve të cilët do të mblidhen në banesë

Mbledhja e mbetjeve në banesat e subjekteve familjarë do të organizohet ekskluzivisht për mbetjet e mëposhtme:

1. Mbetje voluminoze;
2. Të mira materiale të qëndrueshme për përdorim shtëpiak.

Neni 5

Mbetjet voluminoze objekt i rregullores

Në zbatim të kësaj rregulloreje, në kategorinë e mbetjeve voluminoze bëjnë pjesë të gjitha llojet e mobiljeve dhe pajisjeve, të cilat për shkak të përmasave të tyre, nuk mund të transportohen nga qytetarët me mjetet e tyre drejt Qendrës Ekologjike Bashkiake. Të tilla janë:

- Mobilje
- Lavatriçe
- Susta krevati
- Aparatura elektronike (TV, kompjutera)
- Frigoriferë
- B biçikleta
- Mjete elektrike
- Pajisje elektroshtëpiake të mëdha (furra, etj.)
- Dyshekë
- Pajisje kuzhine (lavastovilje, furra me mikrovalë, ngrirës)
- Printera
- Skanera
- Mbetje të tjera elektrike
- Goma
- Bateri

Neni 6

Veçimi, sistemimi dhe Dorëzimi i Mbetjeve voluminoze

Për zbatim të kësaj rregulloreje subjektet duhet të kujdesen për mospërzierjen e mbetjeve voluminoze. Secili grup duhet të grumbullohet më vehte. Në zbatim të këtij neni grupet do të jenë si vijon:

1. Mbetjet voluminoze të parrezikshme
 - a. Mobilje
 - b. Susta krevati
 - c. Bicikleta
 - ç. Dyshekë
2. Mbetjet voluminoze pak të rrezikshme
 - a. Lavatriçe
 - b. Aparatura elektronike
 - c. Frigoriferë
 - ç. Mjete elektrike
 - d. Pajisje elektroshtëpiake të mëdha
 - dh. Pajisje kuzhine
 - e. Printera
 - ë. Skanera
 - f. Mbetje të tjera elektrike
 - g. Goma
3. Mbetje voluminoze të rrezikshme
 - a. Bateri

Neni 7

Shërbimi i mbledhjes në banesë

1. Shërbimi i mbledhjes së materialeve voluminozë në banesë do të kryhet pas njoftimit të dërguar nga qytetari. Për të përfutuar shërbimin, qytetarët duhet t'i drejtohen paraprakisht bashkisë, përfshi edhe njoftimin me telefon, Zyrës së..... në Bashki, e cila bën regjistrimin e kërkesave.
2. Trajtimi i kërkesave do të bëhet brenda një afati 7 (shtatë) ditor. Regjistrimi i kërkesave do të bëhet në një regjistër të veçantë.
3. Çdo kërkesë e dërguar nuk mund të përfshijë më shumë se tri mbetje voluminoze.
4. Bashkia e Himarës në rastet e kërkesave të veçanta, të cilat do të vlerësohen rast pas rasti, autorizon mënyra të ndryshme mbledhjeje me qëllim marrjen e një numri më të madh mbetjesh voluminoze se sa përcakton rregullorja.
5. Shërbimi do të kryhet nga mjetet e bashkisë pa pagesë një herë çdo dy javë dhe përfituesit janë ekskluzivisht qytetarët e bashkisë Himarë.
6. Do të jetë detyrë e bashkisë të njoftojë qytetarët lidhur me ditën kur do të kryhet mbledhja e mbetjeve.

Neni 8

Mënyra e dhënies së shërbimit

1. Materialet voluminozë duhet të vendosen nga ana e qytetarëve, në ditën e parashikuar, pranë banesës së tij, në katin përdhe me akses nga rruga, të mirësishtuar, në mënyrë që manovrimet për marrjen e tyre nga ana e mjetit transportues dhe operatorëve të shërbimit, të kryhen në kohën e duhur pa shkaktuar vonesa në kohë.
2. Qytetari që merr shërbimin është i detyruar t'i vendosë mbetjet në mënyrë të rregullt, duke zenë minimumin e sipërfaqes publike dhe gjithësesi, në mënyrë të tillë që të mos pengojë qarkullimin dhe/ose parkimin e mjeteve.
3. Qytetari që merr shërbimin është i detyruar t'i grumbullojë dhe grupojë mbetjet sipas përcaktimeve të nenit 5 të rregullores.

Neni 9

Transport i mbetjeve voluminoze

1. Transporti publik i mbetjeve voluminoze për në vendet e depozitimit bëhet nga Bashkia ose nga një palë e ngarkuar prej saj (operatori i shërbimit) i caktuar nga Bashkia.
2. Operatorë të tjerë urban që mund të kryejnë aktivitete pastrimi apo grumbullimi, transporti apo depozitimi i mbetjeve, në mënyrë të pavarur nga shërbimi publik duhet të jenë të pajisur me licencë dhe lejet përkatëse.
3. Transporti organizohet e funksionon kryesisht në orët e mbrëmjes ose herët në mëngjes, përveç rasteve të veçanta miratuar nga Bashkia në funksion të sezonit turistik, fluksit, avarive të mjeteve, etj., këto vetëm me autorizim të Bashkisë.
4. Në rastin e zonave rurale, shërbimi i grumbullimit dhe transportit të mbetjeve voluminoze mund të kryhet edhe gjatë orëve të ditës.
5. Transportimi i mbeturinave nga pikat e grumbullimit për në vendet e depozitimit e të përpunimit të tyre, bëhet me mjete teknologjike të mbuluara, ngarkesa e të cilave nuk rrezikon derdhjen apo shpërndarjen e mbeturinave.

Neni 10
Dispozita për subjektet private

Titullarët e subjekteve private prodhuese artizanale, industriale, tregëtare dhe të shërbimit që ushtrojnë aktivitetin e tyre në territorin e bashkisë nuk përfitojnë shërbimin në banesë.

Neni 11
Dorëzimi i mbetjeve vegjetale dhe inerte

1. Përjashtohen nga shërbimi i mbledhjes së mbetjeve voluminoze në banesë materialet vegjetale me origjinë nga krasitja, qethja e barit dhe mirëmbajtja e kopshteve të kryera nga qytetarët privatë, si dhe materialet inerte me origjinë nga shkatërrimet e vogla si rezultat i punimeve ndërtimore në banesa (si p.sh pllaka veshjesh, aparate hidrosanitare, etj.).
2. Përjashtim nga rregulli i mësipërm për mbetjet vegjetale, bëjnë rastet e personave të moshuar mbi 60 vjeç dhe me aftësi të kufizuara dhe pa të afërm që mund të përkujdesen për ta.
3. Mbetjet vegjetale me origjinë nga krasitja, qethja e barit dhe mirëmbajtja e kopshteve duhet të dorëzohen në Qendrën Ekologjike Bashkiake (Stacioni i Transferimit).
4. Gjatë ushtrimit të shërbimit, si personeli i bashkisë, ashtu edhe qytetarët, duhet të respektojnë të gjitha dispozitat ligjore dhe rregulloret në fuqi apo që do të dalin më vonë, si dhe Rregulloren e Manaxhimit të Mbetjeve të Bashkisë Himarë.

Neni 12
Ndalimet

Ndalohen:

- a) hedhja apo groposja e të gjitha llojeve të mbetjeve në vende publike;
- b) hedhja apo groposja e të gjitha llojeve të mbetjeve në anë të kanaleve kulluese e ujitëse, si dhe në çdo vend tjetër ku dëmtohen toka, bimësia dhe kafshët;
- c) hedhja apo groposja e të gjitha llojeve të mbetjeve në toka bujqësore, pyll/kullota;
- ç) djegia e të gjitha llojeve të mbetjeve në kundërshtim me ligjet në fuqi;
- d) braktisja, depozitimi apo asgjësimi i pakontrolluar i mbetjeve.

Neni 13 Sanksionet për shkeljen e rregullores

Shkeljet të dispozitave të kësaj rregulloreje, përbëjnë kundravajtje administrative dhe dënohen sipas modaliteteve dhe mënyrave të parashikuara si më poshtë vijon:

Sanksionet për kundravajtjet administrative, të parashikuara më sipër, ekzekutohen brenda 5 ditëve.

Ankimimi për to bëhet në përputhje me ligjin Nr. 10279, datë 20.05.2010 "Për Kundravajtjet Administrative"

Kundravajtësi përveç se do të riparojë dëmin dhe do të pastrojë ambientin duke e kthyer në gjëndjen e mëparshme, për shkelje administrative do të penalizohet si më poshtë cituar për çdo kategori :

Shkelja	Masa administrative për qytetarë/individë.	Masa administrative për persona fizikë/juridikë
hedhja apo groposja e të gjitha llojeve të mbetjeve voluminoze në vende publike	5000-15000 lekë	50000-75000 lekë
hedhja anë të kanaleve kulluese e ujitëse, si dhe në çdo vend tjetër ku dëmtohen toka, bimësia dhe kafshët	10000-20000 lekë	50000-100000 lekë
hedhja apo groposja e të gjitha llojeve të mbetjeve voluminoze në toka bujqësore, pyll/kullota	5000-15000 lekë	50000-100000 lekë
djegia e të gjitha llojeve të mbetjeve voluminoze në kundërshtim me ligjet në fuqi	10000-20000 lekë	50000-100000 lekë
braktisja, depozitimi apo asgjësimi i pakontrolluar i mbetjeve voluminoze	5000-15000 lekë	50000-100000 lekë
hedhja në det e të gjitha llojeve të mbetjeve voluminoze	10000-20000 lekë	100000 lekë

Neni 14 Sanksionet në rast përsëritje

Në rast përsëritje të shkeljeve në të gjitha rastet do të aplikohet masa maksimale e përcaktuar në neni 13 të rregullores.

Neni 15
Norma integruese

Për gjithçka nuk është e shprehur dhe e përfshirë në këtë rregullore, si normativë referuese do të merret normativa në fuqi.

KRYETARI

Vangjel Tavo

